



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.94

23 qershor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.853, datë 18.6.2008	Për miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave, të organizmit, me fuqi të ndjeshme në treg, “Vodafone Albania”, sh.a.	4073
Vendim i KM nr.854, datë 18.6.2008	Për miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave, të organizmit, me fuqi të ndjeshme në treg, “Albtelecom”, sh.a ..	4081
Vendim i KM nr.855, datë 18.6.2008	Për miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave të organizmit me fuqi të ndjeshme në treg, “Albanian Mobile Communications” (AMC) sh.a.	4097
Vendim i KM nr.856, datë 18.6.2008	Për rritjen e pensioneve	4106
Vendim i ERE nr.61, datë 4.6.2008	Fillimi i procedurës për përcaktimin e tarifës së shitjes me shumicë të energjisë elektrike.....	4108
Vendim i ERE nr.62, datë 4.6.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Union Eolica Albania”	4109

VENDIM
Nr.853, datë 18.6.2008

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË RREGULLIMIT TË TARIFAVE, TË ORGANIZMIT, ME FUQI TË NDJESHME NË TREG, “VODAFONE ALBANIA” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 58, 59, 60 e 62 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave të interkonjeksionit, të organizmit, me fuqi të ndjeshme në treg, “Vodafone Albania” sh.a., sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave të shërbimeve të përdoruesve fundorë, të organizmit, me fuqi të ndjeshme në treg, “Vodafone Albania” sh.a., sipas lidhjes nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim është i vlefshëm për periudhën e parashikuar në metodologjitë, që i bashkëlidhen këtij vendimi (lidhjet nr.1 e nr.2).
4. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

**METODOLOGJI E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË INTERKONJEKSIONIT
TË VODAFONE ALBANIA SHA**

1. Objekti i kësaj metodologjie është rregullimi i tarifës për ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular të operatorit Vodafone Albania.
2. Vodafone Albania të aplikojë të njëjtën tarifë për terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij, pavarësisht origjinës së trafikut, në përmbushje të detyrimit për të ofruar shërbimin e terminimit të thirrjeve të origjinuara nga përdoruesit e rrjeteve publike të telekomunikacioneve dhe të thirrjeve të transituara nga operatorët e licencuar nga ERT për ofrimin e shërbimeve të transitit kombëtar e ndërkombëtar.
3. Rregullimi i tarifës së terminimit bëhet duke përcaktuar nivelin maksimal të tarifave në secilën periudhë rregullimi.
4. Rregullimi i tarifës të shërbimeve të interkonjeksionit sipas kësaj metodologjie do të bëhet për një kohëzgjatje dyvjeçare, e cila përfshin dy periudha njëvjeçare.
5. Vlerat maksimale të tarifës të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular të operatorit Vodafone Albania, për t’u aplikuar për periudhat nënrrregullim paraqiten në tabelën nr.1, në vijim:

Tabela nr.1 Vlerat maksimale të tarifës të terminimit të Vodafone Albania

	Periudha e I-rë	Periudha e II-të
Tarifa (lek/minutë)	11.95	10.50

6. Tarifa e interkonjeksionit për kohëzgjatjen shoqërohet edhe me tarifën për numrin e thirrjeve të terminuara ose transituara, të cilat përcaktohen në masën jo më shumë se 3% përkundrejt tarifës përkatëse për kohëzgjatjen. Tarifa për numrin e thirrjeve zbatohet vetëm për thirrjet, të cilat, sipas rekomandimeve përkatëse të ITU, janë të suksesshme.

7. Nëse gjatë procedurës së rregullimit të tarifave ERT evidenton që operatori nën rregullim kryen veprime që cenojnë konkurrencën në treg, do t'i trajtojë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Data e fillimit të rregullimit përcaktohet me vendim të ERT, i cili merret jo më vonë se 30 ditë mbas hyrjes në fuqi të metodologjisë.

LIDHJA NR.2

METODOLOGJI E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE TË PËRDORUESVE FUNDORË TË VODAFONE ALBANIA SHA

1. Objekti i kësaj metodologjie është rregullimi i tarifave për shërbimet publike telefonike të lëvizshme, që u ofrohen përdoruesve nëpërmjet paketës tarifore me parapagim “Vodafone Card”:

- Thirrje telefonike brenda rrjetit Vodafone Albania;
- Thirrje telefonike kombëtare drejt rrjeteve të tjerë celulare;
- Thirrje telefonike kombëtarë drejt rrjeteve fikse;
- Thirrje telefonike ndërkombëtare.

2. Rregullimi i tarifave, që janë objekt i kësaj metodologjie, bëhet sipas metodës “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” (Price cap).

3. Formula e “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave”, ku bazohet rregullimi i tarifave, është:

$$\sum_{i=1}^n w_{i,t} \left[\frac{p_{i,t} - p_{i,t-1}}{p_{i,t-1}} \right] \leq I_t - X_t$$

ku :

- t : periudha kohore për të cilën vendoset tarifa;
 i : indeksi i shërbimit në shportën nën rregullim ($i = 1, 2, 3, \dots, n$);
 n : numri i shërbimeve në shportën nën rregullim;
 $p_{i,t}$: tarifa (çmimi për njësi) i shërbimit i në periudhën t ;
 $p_{i,t-1}$: tarifa (çmimi për njësi) i shërbimit i në fund të periudhës paraardhëse të periudhës t ;
 $w_{i,t}$: pesha e përdorur e shërbimit i në periudhën t ;
 x_t : faktori i produktivitetit i përdorur në periudhën t ;
 I_t : faktori i inflacionit për periudhën $t-1$;

4. Rregullimi i tarifave me metodën “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” do të aplikohet për një kohëzgjatje dyvjeçare. Kohëzgjatja dyvjeçare përfshin 2 (dy) periudha vjetore.

5. Metoda “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” do të aplikohet për shportën dhe nënshportat e shërbimeve të paraqitura në shtojcën nr.1, pjesë e kësaj metodologjie.

6. Pjesa e mbajtur për thirrjet drejt rrjeteve të tjerë llogaritet si diferencë e tarifës së përdoruesit me detyrimin për terminim dhe/ose transitim ndaj operatorëve të tjerë.

7. Peshat e të ardhurave nga shitja e shërbimit i “wi” llogariten si raport i të ardhurave nga shërbimi “i” me të ardhurat e përgjithshme të shërbimeve në nënshportë/shportë, për vitin kalendarik paraardhës. Peshat e shërbimeve “wi” për periudhën e parë të rregullimit do të jenë peshat e shërbimeve të përlllogaritura nga ERT në bazë të të dhënave të vitit 2006, të depozituara nga Vodafone Albania dhe të paraqitura në shtojcën nr.1, bashkëngjitur. Për periudhën e dytë të rregullimit operatori duhet të depozitojë të dhënat e detajuara të shërbimeve nën rregullim për vitin 2008.

8. Tarifa fillestare ($P_{i,t-1}$) në formulën “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave”, për secilin shërbim nën rregullim, do të jetë tarifa në fund të periudhës paraardhëse.

9. Vlerat vjetore të faktorit X për shportën dhe nënshportat e shërbimeve nën rregullim (shtojca nr.1), do të jenë:

a) Shporta e përgjithshme:

$$X_s = +23\%;$$

b) Nënshporta nr.1: Pjesa e mbajtur për thirrjet kombëtare drejt rrjeteve celularë të tjerë:

$$X_1 = +28\%;$$

c) Nënshporta nr.2 : Pjesa e mbajtur për thirrjet kombëtare drejt rrjeteve fiks:

$$X_2 = +28\%;$$

Vlerat e faktorit X mbeten të pandryshuara për secilën periudhë vjetore rregullimi.

10. Vlera e faktorit I_t (faktori i inflacionit i përdorur për periudhën t) do të jetë i barabartë me normën e ndryshimit vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) të vitit kalendarik paraardhës, të publikuar nga Instituti i Statistikës (INSTAT). Vlera e normës së inflacionit për vitin 2007, që do përdoret për periudhën e parë nën rregullim është 3.1%.

11. Vodafone Albania, duhet të paraqesë propozim për ndryshim të tarifave për secilën periudhë rregullimi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga fillimi i periudhës përkatëse.

12. Vodafone Albania nuk është i kufizuar në lidhje me numrin e propozimeve për ndryshim të tarifave brenda secilës periudhë rregullimi, me kusht që të përmbushë kërkesat e kësaj metodologjie.

13. Vodafone Albania ka të drejtë që, brenda secilës periudhë rregullimi, të aplikojë tarifa më të ulëta se ato të konfirmuara nga ERT duke plotësuar, në çdo rast, detyrimet për njoftim të ERT, si dhe të përdoruesve.

14. Propozimi për ndryshim të tarifave duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm, të kërkuar sipas kësaj metodologjie. ERT, mund të kërkojë, gjithashtu, informacion shtesë për të verifikuar nëse propozimet e paraqitura, përmbushin kërkesat e metodologjisë. Në mungesë të informacionit të nevojshëm, ERT ka të drejtë të përdorë metoda alternative për përlllogaritjen e treguesve të kërkuar.

15. ERT, verifikon përputhshmërinë e tarifave të propozuara me kërkesat e metodologjisë dhe, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e propozimit, njofton Vodafone Albania për rezultatet e verifikimit.

16. Për çdo ndryshim të tarifave, Vodafone Albania detyrohet të njoftojë përdoruesit me anë të mjeteve të informimit publik, të paktën 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave të reja dhe ky njoftim duhet të zgjasë jo më pak se 3 ditë rresht.

17. Vodafone Albania mund të zbatojë kohë minimale të tarifimit për thirrjet telefonike (*start up fee*), e cila nuk duhet të jetë më shumë se 15 sekonda.

18. Vodafone Albania gjatë periudhës nën rregullim nuk mund të propozojë apo aplikojë rritje të tarifave të shërbimeve celulare për planin tarifor nën rregullim Vodafone Card dhe për planet e tjera tarifore, me parapagim apo me kontratë.

19. Vodafone Albania gjatë periudhës nënrregullim duhet të sigurojë vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimeve celulare nëpërmjet planit tarifor Vodafone Card, për përdoruesit aktualë dhe përdoruesit e rinj të mundshëm, si edhe të mos përkeqësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara.

20. Në zbatim të kësaj metodologjie, tarifat të shprehura në monedha të huaja do të konvertohen në lekë, sipas kursit mesatar vjetor, llogaritur në bazë të të dhënave të publikuara nga Banka e Shqipërisë për vitin kalendarik paraardhës.

21. Nëse ERT konstaton se operatori nën rregullim zbaton tarifa në kundërshtim me metodologjinë ose që cenojnë konkurrencën në treg, do t'i trajtojë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi.

22. Shtojca nr.1 dhe shënimet janë pjesë integrale e kësaj metodologjie.

23. Data e fillimit të rregullimit përcaktohet me vendim të ERT-së, i cili merret jo më vonë se 30 ditë pas hyrjes në fuqi të metodologjisë.

Tabela Nr. 1 : SHPORTA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE NËN RREGULLIM

VODAFONE ALBANIA

Vodafone Card

Nr	Shërbimi	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) ëlekë/njësi]			Të ardhura (t-1) ëlekë]	Pesha (Wi) ë %]	Tarifa e propozuar (t) ëlekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI ë %]	Detyrimi për të tjerë (t) ëlekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) ëlekë/njësi]
		Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
1	Biseda telefonike brenda rrjetit Vodafone Albania							0.5557					
	1.1 Brezi orar PEAK							0.5279					
	1.2 Brezi orar OFF-PEAK							0.0278					
2	Biseda telefonike kombëtare drejt operatorëve të tjerë celularë							0.2093					
3	Biseda telefonike kombëtare drejt rrjeteve fiks :							0.0433					
	3.1 Altelecom												
	3.2 Operatoreve të tjerë fiks me interkoneksion indirekt												
	3.3 Operatoreve të tjerë fiks me interkoneksion direkt												
4	Biseda telefonike ndërkombetare drejt:							0.1917					
	4.1.1 ITALI							0.0203					
	4.1.2 ITALI							0.0739					
	4.2.1 GREQI							0.0205					
	4.2.2 GREQI							0.0307					
	4.3.1 MAQEDONI							0.0015					
	4.3.2 MAQEDONI							0.0060					
	4.4.1 KOSOVË							0.0014					
	4.4.2 KOSOVË							0.0069					
	4.5.1 MALI I ZI							0.0003					
	4.5.2 MALI I ZI							0.0024					
	4.6.1 GJERMANI							0.0046					
	4.6.2 GJERMANI							0.0037					
	4.7.1 FRANCË							0.0016					
	4.7.2 FRANCË							0.0021					
	4.8.1 ANGLI							0.0012					

4.8.2		Celular							0.0031					
4.9.1	SHBA	Fiks							0.0112					
4.9.2		Celular												
4.10.1	KANADA	Fiks							0.0002					
4.10.2		Celular												
TOTAL I									1.0000					

SHTOJCA Nr. 1

Tabela Nr. 2 : NËNSHPORTA NR. 1 E SHËRBIMEVE NËN RREGULLIM

VODAFONE ALBANIA

Vodafone Card

Nr	Shërbimi	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) [lekë/njësi]			Të ardhura (t-1) [lekë]	Pesha (Wf) [%]	Tarifa e propozuar (t) [lekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLI [%]	Detyrimi për të tjerë (t) [lekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) [lekë/njësi]
		Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1	2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Biseda telefonike kombëtare drejt operatorëve të tjerë celularë			50									
	TOTALI												

SHTOJCA Nr. 1

Tabela Nr. 3 : NËNSHPORTA NR. 2 E SHËRBIMEVE NËN RREGULLIM

VODAFONE ALBANIA

Vodafone Card

Nr	Shërbimi	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) [lekë/njësi]			Te ardhura (t-1) [lekë]	Pesha (Wi) [%]	Tarifa e propozuar (t) [lekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI [%]	Detyrimi për të tjerë (t) [lekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) [lekë/njësi]
		Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1	2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Biseda telefonike kombëtare drejt rrjeteve fiks :												
	1.1 <i>Albtelecom</i>												
	1.2 <i>Operatoreve të tjerë fiks me interkoneksion indirekt</i>												
	1.3 <i>Operatoreve të tjerë fiks me interkoneksion direkt</i>												
	TOTALI												

SHËNIME
PËR PLOTËSIMIN E TABELAVE TË SHTOJCË NR.1 VODAFONE ALBANIA

1. Kolona nr.1, i referohet emërtimit të shërbimeve aktuale nën rregullim, të ofruara nga VODAFONE ALBANIA nëpërmjet paketës tarifore me parapagim Vodafone Card. Në rast të ndryshimit të emërtimit të shërbimeve apo mënyrës së tarifimit të këtyre shërbimeve, d.m.th. ofrimit të shërbimeve me tarifa të diferencuara sipas kohëzgjatjes apo kohës së kryerjes së thirrjes, VODAFONE ALBANIA duhet t'i specifikojë këto thirrje si shërbime të veçanta dhe t'i përfshijë në kolonën nr.1, duke plotësuar njëkohësisht edhe kolonat e tjera 2-13.

2. Kolona nr.2 dhe nr.3 duhet të plotësohen përkatësisht me sasinë të shprehur në “minuta” dhe “numër thirrje” për të gjitha shërbimet e kolonës nr.1, për periudhën kohore paraardhëse (t-1).

3. Kolonat nr.4, 5 dhe 6 i referohen përkatësisht tarifës së përdoruesit, detyrimit të VODAFONE ALBANIA ndaj operatorëve të tjerë për thirrjet jashtë rrjetit dhe pjesës së mbajtur, për periudhën kohore paraardhëse (t-1). Vlerat e këtyre kolonave të shprehen në lekë, me dy shifra dhjetore.

4. Kolona nr.4 i referohet tarifës së përdoruesit për minutë, pa TVSH.

a) Në rast se Vodafone Albania, përveç tarifës për kohëzgjatjen e bisedës, zbaton edhe një tarifë fikse për thirrje, pavarësisht kohëzgjatjes, në tabelat e shtojcës nr.1, pas kolonës nr.4 duhet të shtohet edhe një kolonë tjetër me nr.4/a “Tarifë për thirrje”, plotësuar me vlerat përkatëse.

5. Kolona nr. 5, i referohet detyrimit të VODAFONE ALBANIA për terminimin (ose dhe transitimin) e thirrjeve drejt rrjeteve të tjerë fiks dhe celulare, kombëtare dhe ndërkombëtare. Për thirrjet brenda rrjetit në këtë kolonë vendoset vlera zero.

a) Në rast se nga operatorët e tjerë, për terminimin (ose dhe transitimin) e thirrjeve në rrjetin e tyre zbatohet edhe një tarifë fikse për thirrje, pavarësisht kohëzgjatjes, në tabelat e shtojcës nr.1, pas kolonës nr.5 duhet të shtohet edhe një kolonë tjetër me nr.5/a “Detyrimi për thirrje”, e cila plotësohet me vlerat përkatëse.

6. Kolona nr.6 i referohet pjesës së mbajtur nga VODAFONE ALBANIA për thirrjet jashtë rrjetit dhe llogaritjet si diferencë e tarifës së përdoruesit (kolona nr.4) dhe detyrimit për të tjerë (kolona nr.5). Për thirrjet brenda rrjetit kjo vlerë rezulton e njëjtë me tarifën e përdoruesit.

a) Në rast të aplikimit nga VODAFONE ALBANIA dhe/ose nga rrjetet e tjerë edhe të një tarife fikse për thirrje pavarësisht kohëzgjatjes, duhet të shtohet edhe një kolonë tjetër nr.6/a “Pjesa e mbajtur për thirrje”, dhe të plotësohet me vlerën përkatëse të barabartë me diferencën e vlerave të tarifës për thirrje (shënimi 4/a) dhe detyrimit për thirrje (shënimi 5/a). Në rast të mosaplikimit të tarifës për thirrje dhe aplikimit të detyrimit për thirrje, pjesa e mbajtur për thirrje të plotësohet me vlerën negative të detyrimit për thirrje.

7. Kolona nr.7 i referohet të ardhurave nga shërbimi përkatës në kolonën nr.1, dhe plotësohet me prodhimin e vlerës në kolonën nr.2 (minuta) dhe vlerës në kolonën nr.6 (Tarifë për minutë), d.m.th. $7=2x6$. Rreshti i fundit i kësaj kolone, totali, të plotësohet me shumën e të ardhurave nga shërbimet e listuara në kolonën e parë.

a) Në rast të aplikimit të shënimi 4/a dhe ose 5/a, kolona nr.7 të plotësohet me shumën e prodhimit të vlerës së minutave (Kolona nr.2) dhe tarifës për minutë (Kolona nr.6) dhe prodhimit të vlerës së numrit të thirrjeve (Kolona nr.3) dhe pjesës së mbajtur për thirrje (shënimi 6/a), d.m.th. $7=2x6+3x6/a$.

8. Kolona nr.8 i referohet peshës së çdo shërbimi në kolonën nr.1 dhe përlllogaritjet për çdo shërbim “i” si raport i të ardhurave nga shërbimi “i” në kolonën nr. 7, me të ardhurat totale nga shërbimet, rreshti i fundit, kolona nr.7. Në rreshtin e fundit të kolonës nr.8 duhet të shënohet shuma e peshave të shërbimeve ($\sum w_i$), e cila duhet të dalë e barabartë me 100%. Vlerat e peshave të shprehen në përqindje me 1 shifër dhjetore. Për periudhën e parë të shtohet një kolonë e re 8/a, me vlerat e përlllogaritura nga Vodafone sipas të dhënave të raportuara në kolonat 1-7.

9. Kolona nr.9 i referohet tarifës së përdoruesit ose pjesës së mbajtur të propozuar nga VODAFONE ALBANIA për periudhën në vijim (t) nën rregullim, pa TVSH. Për thirrjet jashtë rrjetit VODAFONE ALBANIA kjo kolonë duhet të plotësohet me vlerën e pjesës së mbajtur të propozuar, ndërsa për thirrjet brenda rrjetit me vlerën e tarifës së përdoruesit.

10. Kolona nr.10 i referohet normës së ndryshimit (Δp_i) midis tarifës/pjesës së mbajtur të propozuar në kolonën nr.9 dhe Tarifës/Pjesës së mbajtur në periudhën paraardhëse ($t-1$) në kolonën nr.6. Kjo kolonë të plotësohet me vlerën e përlogaritur si raporti i vlerave në kolonën nr.9 dhe kolonën nr.6 minus 1, d.m.th. $10 = (9/6)-1$. Vlerat të shprehen me tre shifra dhjetore.

11. Kolona nr.11 të plotësohet me vlerën e barabartë me prodhimin e vlerave të peshave të shërbimeve (kolona nr.8) dhe vlerave përkatëse të normës së ndryshimit (Kolona nr.10), d.m.th. $11=8 \times 10$. Rreshti i fundit i kolonës nr.11, të plotësohet me shumën e vlerave të kësaj kolone $\sum w_i \Delta p_i$. Të bëhet kujdes në mos-përfshirjen dy herë të vlerave për një shërbim me tarifa të diferencuara. Në mënyrë që tarifat (pjesa e mbajtur) e propozuara nga VODAFONE ALBANIA në kolonën nr.9, të përmbushin kriteret e rregullimit të metodologjisë dhe të miratohen nga ERT, vlera e kësaj qelize të matricës duhet të jetë më e vogël ose e barabartë me vlerën e shprehjes së përcaktuar në tabelën përkatëse:

a) për tabelën nr.1, shporta e përgjithshme: $\sum w_i \Delta p_i \leq I_{t-1} - 23\%$

b) për tabelën nr.2, nënshporta nr.1: $\sum w_i \Delta p_i \leq I_{t-1} - 28\%$

c) për tabelën nr.3, nënshporta nr.2: $\sum w_i \Delta p_i \leq I_{t-1} - 28\%$

12. Kolona nr.12 i referohet detyrimit të VODAFONE ALBANIA si në kolonën nr.5 (shih shënim 5) por për periudhën nënrrregullim në vijim (t). Kjo kolonë të plotësohet me vlerën e detyrimit në periudhën në vijim në rast se njihet në avancë nga VODAFONE ALBANIA, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me operatorë të tjerë, ose me vlerat e tarifave të rregulluara nga ERT, sipas metodologjive përkatëse. Në rast të kundert, lihen bosh ose plotësohen me të njëjtën vlerë si kolona nr.5 (shih shënim 5).

13. Kolona nr.13 i referohet tarifës së përdoruesit që do aplikohet nga VODAFONE ALBANIA në periudhën nën rregullim në vijim (t). Për thirrjet brenda rrjetit kjo tarifë është e njëjte me tarifën e propozuar nga VODAFONE ALBANIA në kolonën nr.9, ndërsa për thirrjet jashtë rrjetit VODAFONE ALBANIA, tarifa e përdoruesit që do aplikohet duhet të jetë e barabartë me shumën e pjesës së mbajtur të propozuar nga VODAFONE ALBANIA në kolonën nr.9 dhe detyrimit në kolonën nr.12, me kushtin që tarifat dhe pjesët e mbajtura, të propozuara nga VODAFONE ALBANIA, të miratohen nga ERT. Në rast të reduktimit të detyrimit në kolonën nr.12 gjatë periudhës nën rregullim në vijim (t), VODAFONE ALBANIA duhet të reduktojë tarifën e përdoruesit në masë absolute të njëjtë me reduktimin e detyrimit.

14. Tabelat e plotësuara duhet të depozitohen nga VODAFONE ALBANIA në formë të printuar dhe në formë elektronike në CD në formatin EXCEL.

VENDIM

Nr.854, datë 18.6.2008

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË RREGULLIMIT TË TARIFAVE, TË ORGANIZMIT, ME FUQI TË NDJESHME NË TREG, "ALBTELECOM", SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 58, 59, 60 e 62 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000, "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave të interkonjeksionit, të organizmit, me fuqi të ndjeshme në treg, "Albtelecom", sh.a., sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave të shërbimeve të përdoruesve fundorë, të organizmit, me fuqi të ndjeshme në treg, "Albtelecom" sh.a., sipas lidhjes nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Vendimi nr.582, datë 21.8.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave, me fuqi të ndjeshme në treg, që ofrojnë shërbime publike telefonike, të qëndrueshme, dhe linja me qira”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ky vendim është i vlefshëm për periudhën e parashikuar në metodologjitë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

**METODOLOGJI E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË INTERKONJEKSIONIT
TË ALBTELECOM SHA**

1. Objekti i kësaj metodologjie është rregullimi i tarifave për shërbimet e interkonjeksionit, si më poshtë:

a) Terminim i thirrjeve telefonike në rrjetin Albtelecom sipas segmenteve përkatëse:

- i) segment lokal;
- ii) segment i njëfishtë;
- iii) segment i dyfishtë.

b) Transitim i thirrjeve telefonike kombëtare në rrjetin Albtelecom, sipas segmenteve përkatëse:

- i) segment i njëfishtë;
- ii) segment i dyfishtë.
- c) Transitim i thirrjeve hyrëse dhe dalëse ndërkombëtare nëpërmjet rrjetit Albtelecom.

2. Rregullimi i tarifave për shërbimet e interkonjeksionit bëhet duke përcaktuar nivelin maksimal të tarifave në secilën periudhë rregullimi.

3. Rregullimi i tarifave të shërbimeve të interkonjeksionit sipas kësaj metodologjie do të bëhet për një kohëzgjatje dyvjeçare, e cila përfshin katër periudha gjashtëmujore.

4. Vlerat maksimale të tarifave të terminimit për t'u aplikuar nga Albtelecom sh.a. për periudhat nën rregullim paraqiten në tabelën nr.1 në vijim.

Tabela nr.1. Vlerat maksimale të tarifave të terminimit të Albtelecom
(lekë/minutë)

	Periudha e I-re	Periudha e II-të	Periudha e III-të	Periudha e IV-te
Terminimi:				
Segment lokal	0.92	0.84	0.77	0.70
Segment njëfish	1.81	1.52	1.27	1.06
Segment dyfish	2.30	2.01	1.76	1.54

5. Vlerat maksimale për tarifën e interkonjeksionit për shërbimet e “Transitimit”, për t'u aplikuar nga Albtelecom sh.a. gjatë periudhave nën rregullim përcaktohen në bazë të tarifave të “Terminimit” të periudhës përkatëse në tabelë nr.1, sipas relacioneve të mëposhtme:

- a) Transitim i njëfishtë = Tarifa e terminimit (Segment Nfish) - Tarifa e terminimit (Segment Lokal)
- b) Transitim i dyfishtë = Tarifa e terminimit (Segment i Dyfishtë) - Tarifa e terminimit (Segment Lokal)
- c) Tranzitim ndërkombëtar (hyrës dhe dalës) = Transitim i njëfishtë + Transitim i dyfishtë

- Tarifa e pikës 5(c) përfaqëson detyrimin e operatorëve vendas/të huaj për Albtelecom për transitimin e thirrjeve dalëse/hyrëse ndërkombëtare. Pala origjinuese e trafikut (që dorëzon trafikun në POI me Albtelecom) i paguan Albtelecom detyrimin e transitit ndërkombëtarë dhe detyrimin për terminimin e trafikut sipas marrëveshjeve të Albtelecom me operatorët vendas dhe të huaj.

- Albtelecom të depozitohet në ERT marrëveshjet e interkonjeksionit (apo të shkëmbimit të trafikut) dhe çdo amendim të lidhura me operatorët/bartësit ndërkombëtarë për trafikun hyrës/dalës ndërkombëtar.

6. Tarifat e interkonjeksionit për kohëzgjatjen shoqërohen edhe me tarifën për numrin e thirrjeve të terminuara ose transituara, të cilat përcaktohen në masën jo më shumë se 3% përkundrejt tarifave përkatëse për kohëzgjatjen. Tarifën për numrin e thirrjeve zbatohen vetëm për thirrjet të cilat, sipas rekomandimeve përkatëse të ITU, janë të suksesshme.

7. Nëse gjatë procedurës së rregullimit të tarifave ERT evidenton që operatori nën rregullim kryen veprime që cenojnë konkurrencën në treg, ERT do t'i trajtojë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Data e fillimit të rregullimit përcaktohet me vendim të ERT-së, i cili merret jo më vonë se 30 ditë mbas hyrjes në fuqi të metodologjisë.

LIDHJA NR.2

METODOLOGJI E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE TË PËRDORUESVE FUNDORË TË ALBTELECOM SHA

1. Objekti i kësaj metodologjie është rregullimi i tarifave të Albtelecom sh.a. për shërbimet që u ofrohen përdoruesve fundorë, të kategorive “Familjarë” dhe “Të tjerë”:

- a) Akses në rrjetin Albtelecom (pajtim mujor, instalim);
- b) Thirrje lokale;
- c) Thirrje kombëtare brenda rrjetit Albtelecom;
- d) Thirrje kombëtare drejt rrjeteve të tjerë fiks;
- e) Thirrje drejt rrjeteve celulare;
- f) Thirrje ndërkombëtare.

2. Rregullimi i tarifave të shërbimeve, që janë objekti i kësaj metodologjie, bëhet sipas metodës “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” (*Price cap*).

3. Formula e metodës “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave”, ku bazohet rregullimi i tarifave, është:

$$\sum_{i=1}^n w_{i,t} \left[\frac{p_{i,t} - p_{i,t-1}}{p_{i,t-1}} \right] \leq I_t - X_t$$

ku :

- t : periudha kohore për të cilin vendoset çmimi;
- i : indeksi i shërbimit në shportën nën rregullim (i = 1,2,3,...,n);
- n : numri i shërbimeve në shportën nën rregullim;
- $p_{i,t}$: tarifa (çmimi për njësi) i shërbimit i në periudhën t;
- $p_{i,t-1}$: tarifa (çmimi për njësi) i shërbimit i në fund të periudhës paraardhëse të periudhës t;
- $w_{i,t}$: pesha e përdorur e shërbimit i në periudhën t;

X_t : faktori i produktivitetit i përdorur në periudhën t;

I_t : faktori i inflacionit për periudhën t-1;

4. Metoda “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” do të aplikohet për shportën dhe nënshportat e shërbimeve të paraqitura në shtojcën nr.1, pjesë e kësaj metodologjie.

5. Rregullimi i tarifave me metodën “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” do të aplikohet për një kohëzgjatje dyvjeçare. Kohëzgjatja dyvjeçare përfshin 4 (katër) periudha 6-mujore.

6. Peshat e të ardhurave nga shitja e shërbimit i “wi” llogariten si raport i të ardhurave nga shërbimi “i” me të ardhurat e përgjithshme të shërbimeve në nënshportë/shportë, për vitin kalendarik paraardhës.

7. Tarifa (p_{i,t-1}) në formulën e “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave”, për secilin shërbim nën rregullim, do të jetë tarifa në fund të periudhës paraardhëse.

8. Për shërbimin thirrje lokale, tarifa (p_{i,t-1}), për periudhën e parë nën rregullim do të jetë e barabartë me të ardhurën mesatare për minutë (të ardhura pjesëtuar me numër minutash) sipas brezit kohor dhe kategorisë së pajtimtarit, të përlllogaritur për vitin 2006.

9. Pjesa e mbajtur për thirrjet drejt rrjeteve të tjerë llogaritet si diferencë e tarifës së përdoruesit me detyrimin për terminim dhe/ose transitim ndaj operatorëve të tjerë.

10. Vlerat e faktorit X për shportën dhe nënshportat e shërbimeve nën rregullim (shtojca nr.1), për secilën periudhë 6-mujore do të jenë:

a) Shporta përgjithshme:

$$X_s = I_t;$$

b) Nënshporta nr.1 - Pajtimi mujor për kategorinë “Familjarë”:

$$X_1 = - 20.00 \%;$$

c) Nënshporta nr.2 - Thirrje telefonike kombëtare (midis rajoneve) për kategorinë “Familjarë”:

$$X_2 = + 15.00\%;$$

d) Nënshporta nr.3 - Thirrje lokale:

$$X_3 = - 10.50 \%;$$

e) Nënshporta 4: pjesa e mbajtur për thirrjet ndërkombëtare:

$$X_4 = + 15 \%;$$

Rritja maksimale nominale (RPI-X) e tarifës së thirrjeve lokale në brezin kohor i zakonshëm për pajtimtarët e kategorisë familjarë (zëri 3.1.1 në tabelë nr.1 dhe zëri 1.1.1 në tabelë nr.4 të shtojcës nr.1) të jetë 12%.

Vlerat e faktorit X mbeten të pandryshuara për secilën periudhë 6-mujore të rregullimit.

11. Vlera e faktorit I_t (faktori i inflacionit i përdorur për periudhën t) do të jetë i barabartë me normën e ndryshimit vjetor të indeksit të çmimeve të Konsumit (IÇK) të vitit kalendarik paraardhës, të publikuar nga Instituti i Statistikës (INSTAT), të shprehur në një shifër dhjetore. Vlera e normës së inflacionit për vitin 2007, që do përdoret për periudhën e parë nën rregullim është 3.1%.

12. Altelecom, duhet të paraqesë propozim për ndryshim të tarifave për secilën periudhë rregullimi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të periudhës përkatëse.

13. Altelecom nuk është i kufizuar në lidhje me numrin e propozimeve për ndryshim të tarifave brenda secilës periudhë rregullimi, me kusht që të përmbushë kërkesat e kësaj metodologjie.

14. Altelecom ka të drejtë që, brenda secilës periudhë rregullimi, të aplikojë reduktim të tarifave të konfirmuara nga ERT-ja, duke plotësuar, në çdo rast, detyrimet për njoftim të ERT-së, si dhe të përdoruesve.

15. Propozimi për ndryshim të tarifave duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm, të kërkuar sipas kësaj metodologjie. ERT mund të kërkojë, gjithashtu, informacion shtesë për të verifikuar nëse propozimet e paraqitura përmbushin kërkesat e metodologjisë. Në mungesë të informacionit të nevojshëm, ERT ka të drejtë të përdorë metoda alternative për përlllogaritjen e treguesve të kërkuar.

16. ERT verifikon përputhshmërinë e tarifave të propozuara me kërkesat e metodologjisë dhe, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e propozimit, njofton Altelecom për rezultatet e verifikimit.

17. Për çdo ndryshim të tarifave, i licencuari detyrohet t'i njoftojë përdoruesit me anë të mjeteve të informimit publik, të paktën 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave të reja dhe ky njoftim duhet të zgjasë jo më pak se 3 ditë rresht.

18. Altelecom gjatë periudhës së parë 6 - mujore mund të zbatojë tarifimin me unitete në komunikimet telefonike lokale, por kohëzgjatja e një uniteti nuk duhet të jetë më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) sekonda. Në periudhat e tjera sistemi i tarifimit edhe për bisedat lokale të bëhet tërësisht mbi bazë sekonde.

19. Altelecom mund të zbatojë diferencim ndërmjet tarifave për thirrjet telefonike për përdoruesit "Familiarë" dhe "Të Tjerë", por në fund të periudhës dyvjeçare të rregullimit, periudha e IV, të mos ketë diferencë në tarifa për shërbime të njëjta, të ofruara në kushte të njëjta.

20. Altelecom, gjatë periudhës nën rregullim nuk i lejohet të rrisë tarifën për përdoruesit "Familjarë" të lidhjes bashkëngjitur, përveçse për shërbimet e nënshportave që imponohet rritje e tarifës nëpërmjet X negativ.

21. Altelecom mund të përdorë diferencim të tarifave të thirrjeve telefonike sipas jo më shumë se dy nivele të ndryshme tarifore, të shpërndarë në dy breza kohorë të vazhdueshëm.

22. Në zbatim të kësaj metodologjie, tarifën të shprehura në monedha të huaja do të konvertohen në lekë, sipas kursit mesatar vjetor, llogaritur në bazë të të dhënave të publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin kalendarik paraardhës.

23. Nëse ERT konstaton se Altelecom zbaton tarifa në kundërshtim me metodologjinë, ose që çënojnë konkurrencën në treg, do t'i trajtojë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi.

24. Shtojca nr.1 dhe shënimet janë pjese integrale e kësaj metodologjie.

25. Data e fillimit të rregullimit përcaktohet me vendim të ERT, i cili merret jo më vonë se 30 ditë mbas hyrjes në fuqi të metodologjisë.

SHTOJCA Nr. 1

Tabela Nr. 1 : SHPORTA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE NËN RREGULLIMË

ALBTELECOM

Nr	Shërbimi	Kategoria e pajtimarëve	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) ëlekë/njësi]			Të ardhura (t-1) ëlekë]	Pesha (Wi) %]	Tarifa e propozuar (t) ëlekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI %]	Detyrimi për të tjerët (t) ëlekë/njësi]	Tarifa e perdoruesit (t) ëlekë/njësi]
			Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për te tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1		2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	1.1	Pajtimi mujor	Familjarë											
	1.2		Të tjerë											
2	2.1	Instalimi telefonik	Familjarë											
	2.2		Të tjerë											
3		Biseda telefonike LOKALE												
	3.1.1	Brezi orar i ZAKONSHËM	Familjarë											
	3.1.2	Brezi orar i REDUKTUAR	Familjarë											
	3.2.1	Brezi orar i ZAKONSHËM	Të tjerë											
3.2.2	Brezi orar i REDUKTUAR	Të tjerë												
4		Biseda telefonike KOMBËTARE brënda rrjetit Albtelecom												
	4.1.1	Brënda Rajonit	Familjare											
	4.1.2	Midis Rajoneve	Familjare											
	4.2.1	Brënda Rajonit	Të tjerë											
4.2.2	Midis Rajoneve	Të tjerë												
5		Biseda telefonike KOMBËTARE drejt rrjeteve të tjerë fiks												
	5.1.1	Lokale	Familjarë											
	5.1.2	Brenda Rajonit	Familjarë											
	5.1.3	Midis Rajoneve	Familjarë											
	5.2.1	Lokale	Të tjerë											
	5.2.2	Brënda Rajonit	Të tjerë											
5.2.3	Midis Rajoneve	Të tjerë												
6		Biseda telefonike KOMBËTARE drejt rrjeteve celulare												

	6.1.1		Brezi orar PIK	Familjarë															
	6.1.2		Brezi orar i ZAKONSHËM	Familjarë															
	6.1.3		Brezi orar i REDUKTUAR	Familjarë															
	6.2.1		Brezi orar PIK	Të tjerë															
	6.2.2		Brezi orar i ZAKONSHËM	Te tjere															
	6.2.3		Brezi orar i REDUKTUAR	Të tjerë															
7			Biseda telefonike NDERKOMBËTARE, brezi orar PIK, drejt:																
	7.1.1	ITALI	Fiks	Familjarë															
	7.1.2		Celular	Familjarë															
	7.2.1	GREQI	Fiks	Familjarë															
	7.2.2		Celular	Familjarë															
	7.3.1	MAQEDONI	Fiks	Familjarë															
	7.3.2		Celular	Familjarë															
	7.4.1	KOSOVË	Fiks	Familjarë															
	7.4.2		Celular	Familjarë															
	7.5.1	MALI I ZI	Fiks	Familjarë															
	7.5.2		Celular	Familjarë															
	7.6.1	GJERMANI	Fiks	Familjarë															
	7.6.2		Celular	Familjarë															
	7.7.1	FRANCË	Fiks	Familjarë															
	7.7.2		Celular	Familjarë															
	7.8.1	ANGLI	Fiks	Familjarë															
	7.8.2		Celular	Familjarë															
	7.9.1	SHBA	Fiks	Familjarë															
	7.9.2		Celular	Familjarë															
	7.10.1	KANADA	Fiks	Familjarë															
	7.10.2		Celular	Familjarë															
8			Biseda telefonike NDERKOMBËTARE, brezi orar PIK, drejt:																
	8.1.1	ITALI	Fiks	Të tjerë															
	8.1.2		Celular	Të tjerë															
	8.2.1	GREQI	Fiks	Të tjerë															
	8.2.2		Celular	Të tjerë															

	9.9.2		Celular	Familjarë													
	9.10.1	KANADA	Fiks	Familjarë													
	9.10.2		Celular	Familjarë													
10		Biseda telefonike NDERKOMBETARE, brezi orar REDUKTUAR, drejt:															
	10.1.1	ITALI	Fiks	Të tjerë													
	10.1.2		Celular	Të tjerë													
	10.2.1	GREQI	Fiks	Të tjerë													
	10.2.2		Celular	Të tjerë													
	10.3.1	MAQEDONI	Fiks	Të tjerë													
	10.3.2		Celular	Të tjerë													
	10.4.1	KOSOVË	Fiks	Të tjerë													
	10.4.2		Celular	Të tjerë													
	10.5.1	MALI I ZI	Fiks	Të tjerë													
	10.5.2		Celular	Të tjerë													
	10.6.1	GJERMANI	Fiks	Të tjerë													
	10.6.2		Celular	Të tjerë													
	10.7.1	FRANCE	Fiks	Të tjerë													
	10.7.2		Celular	Të tjerë													
	10.8.1	ANGLI	Fiks	Të tjerë													
	10.8.2		Celular	Të tjerë													
	10.9.1	SHBA	Fiks	Të tjerë													
	10.9.2		Celular	Të tjerë													
	10.10.1	KANADA	Fiks	Të tjerë													
	10.10.2		Celular	Të tjerë													
	TOTALI																

SHTOJCA Nr. 1

Tabela Nr. 2 : NËNSHPORTA Nr. 1 E SHËRBIMEVE NËN RREGULLIM

ALBTELECOM

Nr	S hërbi m i	Kategoria e pajtimtarëve	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) [lekë/njësi]			Te ardhura (t-1) [lekë]	Pesha (Wi) [%]	Tarifa e përdoruesit (t) [lekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI [%]	Tarifa e përdoruesit (t) [lekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) [lekë/njësi]
			Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1		2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Pajtimi mujor	Familjarë												
	TOTALI													

SHTOJCA Nr. 1

Tabela Nr. 3 : NENSHPORTA Nr. 2 E SHERBIMEVE NEN RREGULLIM

ALBTELECOM

Nr	Shërbimi	Kategoria e pajtimtarëve	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) [ëlekë/njësi]			Te ardhura (t-1) [ëlekë]	Pesha (Wi) [%]	Tarifa e përdoruesit (t) [ëlekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI [%]	Tarifa e përdoruesit (t) [ëlekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) [ëlekë/njësi]
			Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1		2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Biseda telefonike KOMBËTARE brënda rrjetit Albtelecom "Midis Rajoneve"	Familjarë												
	TOTALI													

Nr	Shërbimi	Kategoria e pajuntarëve	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) [ëlekë/njësi]			Te ardhura (t-1) [ëlekë/njësi]fa (t-1) [ëlekë/njësi]	Pesha (Wi) [%]	Tarifa e propozuar (t) [ëlekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI [%]	Detyrimi për te tjerët (t) [ëlekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) [ëlekë/njësi]
			Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1		2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Biseda telefonike LOKALE													
1.1.1	<i>Brezi orar i ZAKONSHËM</i>	Familjarë												
1.1.2	<i>Brezi orar i REDUKTUAR</i>	Familjarë												
1.2.1	<i>Brezi orar i ZAKONSHËM</i>	Të tjerë												
1.2.2	<i>Brezi orar i REDUKTUAR</i>	Të tjerë												
	TOTALI													

Nr	Shërbimi	Kategoria e pajtuarëve	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) [ëlekë/njësi]			Te ardhura (t-1) [ëlekë]	Pesha (Wi) [ë %]	Tarifa e propozuar (t) [ëlekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI [ë %]	Detyrimi për të tjerët [ëlekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) [ëlekë/njësi]
			Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1		2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Biseda telefonike NDERKOMBËTARE, brezi orar PIK, drejt:													
1.1.1	ITALI	Fiks	Familjarë											
1.1.2		Celular	Familjarë											
1.2.1	GREQI	Fiks	Familjarë											
1.2.2		Celular	Familjarë											
1.3.1	MAQEDONI	Fiks	Familjarë											
1.3.2		Celular	Familjarë											
1.4.1	KOSOVË	Fiks	Familjarë											
1.4.2		Celular	Familjarë											
1.5.1	MALI I ZI	Fiks	Familjarë											
1.5.2		Celular	Familjarë											
1.6.1	GJERMANI	Fiks	Familjarë											
1.6.2		Celular	Familjarë											
1.7.1	FRANCË	Fiks	Familjarë											
1.7.2		Celular	Familjarë											
1.8.1	ANGLI	Fiks	Familjarë											
1.8.2		Celular	Familjarë											
1.9.1	SHBA	Fiks	Familjarë											
1.9.2		Celular	Familjarë											
1.10.1	KANADA	Fiks	Familjarë											
1.10.2		Celular	Familjarë											

2		Biseda telefonike NDERKOMBETARE, brezi orar PIK, drejt:																	
	2.1.1	ITALI	Fiks	Të tjerë															
	2.1.2		Celular	Të tjerë															
	2.2.1	GREQI	Fiks	Të tjerë															
	2.2.2		Celular	Të tjerë															
	2.3.1	MAQEDONI	Fiks	Të tjerë															
	2.3.2		Celular	Të tjerë															
	2.4.1	KOSOVË	Fiks	Të tjerë															
	2.4.2		Celular	Të tjerë															
	2.5.1	MALI I ZI	Fiks	Të tjerë															
	2.5.2		Celular	Të tjerë															
	2.6.1	GJERMANI	Fiks	Të tjerë															
	2.6.2		Celular	Të tjerë															
	2.7.1	FRANCË	Fiks	Të tjerë															
	2.7.2		Celular	Të tjerë															
	2.8.1	ANGLI	Fiks	Të tjerë															
	2.8.2		Celular	Të tjerë															
	2.9.1	SHBA	Fiks	Të tjerë															
	2.9.2		Celular	Të tjerë															
	2.10.1	KANADA	Fiks	Të tjerë															
	2.10.2		Celular	Të tjerë															
3		Biseda telefonike NDERKOMBËTARE, brezi orar REDUKTUAR, drejt:																	
	3.1.1	ITALI	Fiks	Familjarë															
	3.1.2		Celular	Familjarë															
	3.2.1	GREQI	Fiks	Familjarë															
	3.2.2		Celular	Familjarë															
	3.3.1	MAQEDONI	Fiks	Familjarë															
	3.3.2		Celular	Familjarë															
	3.4.1	KOSOVË	Fiks	Familjarë															
	3.4.2		Celular	Familjarë															
	3.5.1	MALI I ZI	Fiks	Familjarë															
	3.5.2		Celular	Familjarë															

	3.6.1	GJERMANI	Fiks	Familjarë															
	3.6.2			Celular	Familjarë														
	3.7.1	FRANCË	Fiks	Familjarë															
	3.7.2			Celular	Familjarë														
	3.8.1	ANGLI	Fiks	Familjarë															
	3.8.2			Celular	Familjarë														
	3.9.1	SHBA	Fiks	Familjarë															
	3.9.2			Celular	Familjarë														
	3.10.1	KANADA	Fiks	Familjarë															
	3.10.2			Celular	Familjarë														
4		Biseda telefonike NDERKOMBETARE, brezi orar REDUKTUAR, drejt:																	
	4.1.1	ITALI	Fiks	Të tjerë															
	4.1.2			Celular	Të tjerë														
	4.2.1	GREQI	Fiks	Të tjerë															
	4.2.2			Celular	Të tjerë														
	4.3.1	MAQEDONI	Fiks	Të tjerë															
	4.3.2			Celular	Të tjerë														
	4.4.1	KOSOVE	Fiks	Të tjerë															
	4.4.2			Celular	Të tjerë														
	4.5.1	MALI I ZI	Fiks	Të tjerë															
	4.5.2			Celular	Të tjerë														
	4.6.1	GJERMANI	Fiks	Të tjerë															
	4.6.2			Celular	Të tjerë														
	4.7.1	FRANCE	Fiks	Të tjerë															
	4.7.2			Celular	Të tjerë														
	4.8.1	ANGLI	Fiks	Të tjerë															
	4.8.2			Celular	Të tjerë														
	4.9.1	SHBA	Fiks	Të tjerë															
	4.9.2			Celular	Të tjerë														
	4.10.1	KANADA	Fiks	Të tjerë															
	4.10.2			Celular	Të tjerë														
	TOTALI																		

SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E TABELAVE TË SHTOJCA NR.1 ALBTELECOM

1. Kolona nr.1 i referohet emërtimit të shërbimeve aktuale nën rregullim, të ofruara nga ALBTELECOM pajtimtarëve të dy kategorive “Familjarë” dhe “Të tjerë”. Në rast të ndryshimit të emërtimit të shërbimeve apo menyrës së tarifimit të këtyre shërbimeve, d.m.th. ofrimit të shërbimit të kryerjes së thirrjes, ALBTELECOM duhet t’i specifikojë këto thirrje si shërbime të veçanta dhe t’i përfshijë në kolonë nr.1, duke plotësuar njëkohësisht edhe kolonat e tjera 2-13.

2. Kolona nr.2 dhe nr.3 duhet të plotësohen përkatesisht me sasinë të shprehur në “minuta” dhe “numër thirrje” për të gjitha shërbimet e kolonës nr.1, me numër rendor 3-10 dhe, për shërbimet e tjera të plotësohet duke përdorur njësinë matëse numër, që mund të jetë pajtimtarë.

3. Kolonat nr.4, 5 dhe 6 i referohen përkatesisht tarifës së përdoruesit, detyrimit të ALBTELECOM ndaj operatorëve të tjerë për thirrjet jashtë rrjetit dhe pjesës së mbajtur, për periudhën kohore paraardhëse (t-1). Vlerat e këtyre kolonave të shprehen në lekë, me dy shifra dhjetore.

4. Kolona nr.4 i referohet tarifës së përdoruesit për minutë, pa TVSH.

a) Në rast se Albtelecom, përveç tarifës për kohëzgjatjen e bisedës, zbaton edhe një tarifë fikse për thirrje, pavarësisht kohëzgjatjes, në tabelat e shtojcën nr.1, pas kolonës nr.4 duhet të shtohet edhe një kolonë tjetër me nr.4/a “tarifë për thirrje”, e cila plotësohet me vlerat përkatëse.

5. Kolona nr.5 i referohet detyrimit të ALBTELECOM për terminimin (ose dhe transitimin) e thirrjeve drejt rrjeteve të tjerë fiks dhe celularë, kombëtare dhe ndërkombëtare. Për thirrjet brenda rrjetit Albtelecom dhe shërbimet e tjera në këtë kolonë vendoset vlera zero.

a) Në rast se nga operatorët e tjerë, për terminimin (ose dhe transitimin) e thirrjeve në rrjetin e tyre zbatohet edhe një tarifë fikse për thirrje, pavarësisht kohëzgjatjes, në tabelat e shtojcës nr.1, pas kolonës nr.5 duhet të shtohet edhe një kolonë tjetër me nr.5/a “Detyrimi për thirrje”, e plotësuar me vlerat përkatëse.

6. Kolona nr.6 i referohet pjesës së mbajtur nga ALBTELECOM për thirrjet jashtë rrjetit, e cila llogaritet si diferencë e tarifës së përdoruesit (kolona nr.4) dhe detyrimit për të tjerë (kolona nr.5). Për thirrjet brenda rrjetit kjo vlerë rezulton e njëjtë me tarifën e përdoruesit.

a) Në rast se aplikimit nga ALBTELECOM dhe/ose nga rrjetet e tjerë edhe të një tarife fikse për thirrje kolonë tjetër nr.6/a, pjesa e mbajtur për thirrje, dhe të plotësohet me vlerën përkatëse të barabartë me diferencën e vlerave të tarifës për thirrje (shënimi 4/a) dhe detyrimit për thirrje (shënimi 5/a). Në rast të mosaplikimit të tarifës për thirrje dhe aplikimit të detyrimit për thirrje, pjesa e mbajtur për thirrje të plotësohet me vlerën negative të detyrimit për thirrje.

7. Kolona nr.7 i referohet të ardhurave nga shërbimi përkatës në kolonën nr.1, dhe plotësohet me prodhimin e vlerës në kolonën nr.2 (minuta) dhe vlerës në kolonën nr.6 (Tarifë për minutë) d.m.th. $7=2 \times 6$. Rreshti i fundit i kësaj kolone, totali, të plotësohet me shumën e të ardhurave nga shërbimet e listuara në kolonën e parë.

a) Në rast të aplikimit të shënimit 4/a dhe/ose 5/a, kolona nr.7 të plotësohet me shumën e prodhimit të vlerës së minutave (kolonën nr.2) dhe tarifës për minutë (kolonën nr.6) dhe prodhimit të vlerës së numrit të thirrjeve (kolonën nr.3) dhe pjesës së mbajtur për thirrje (shënimi 6/a), d.m.th. $7=2 \times 6 + 3 \times 6/a$.

8. Kolona nr.8 i referohet peshës së çdo shërbimi në kolonën nr.1, dhe përlllogaritet për çdo shërbim “i” si raport i të ardhurave nga shërbimi “i” në kolonën nr. 7, dhe të ardhurave totale nga shërbimet, rreshti i fundit, kolona nr.7. Në rreshtin e fundit të kolonës nr.8 duhet të shënohet shuma e peshave të shërbimeve ($\sum w_i$), e cila duhet të dalë e barabartë me 100%. Vlerat e peshave të shprehen në përqindje me 1 shifër dhjetore.

9. Kolona nr.9 i referohet tarifës së përdoruesit ose pjesës së mbajtur të propozuar nga ALBTELECOM për periudhën në vijim (t) nën rregullim, pa TVSH. Për thirrjet jashtë rrjetit ALBTELECOM kjo kolonë duhet të plotësohet me vlerën e pjesës së mbajtur të propozuar, ndërsa për thirrjet brenda rrjetit dhe shërbimet e tjera me vlerën e tarifës së përdoruesit.

10. Kolona nr.10 i referohet normës së ndryshimit (Δp_i) midis tarifës/pjesës së mbajtur së propozuar në kolonën nr.9 dhe tarifës/pjesës së mbajtur në periudhën paraardhëse (t-1) në kolonën 4096

nr.6. Kjo kolonë të plotësohet me vlerën e përlogaritur si raport i vlerave në kolonën nr.9 dhe kolonën nr.6 minus 1, d.m.th. $10 = (9/6)-1$. Vlerat të shprehen me tri shifra dhjetore.

11. Kolona nr.11 të plotësohet me vlerën e barabartë me prodhimin e vlerave të peshave të shërbimeve (kolona nr.8) dhe vlerave përkatëse të normës së ndryshimit (kolona nr.10), d.m.th $11=8 \times 10$. Rreshti i fundit i kolonës nr.11, të plotësohet me shumën e vlerave të kësaj kolone $\sum w_i \cdot \Delta p_i$. Në mënyrë që tarifat (pjesa e mbajtur) e propozuara nga ALBTELECOM në kolonën nr.9, të përmbushin kriteret e rregullimit të metodologjisë dhe të miratohen nga ERT, vlera e kësaj qelize të matricës duhet të jetë më e vogël ose e barabartë me vlerën e shprehjes së përcaktuar në tabelën përkatëse:

- a) për tabelën nr.1, shporta e përgjithshme: $\sum w_i \cdot \Delta p_i \leq I_{t-1} - I_{t-1}$
- b) për tabelën nr.2, nën shporta nr.1, pajtimi mujor familjare: $\sum w_i \cdot \Delta p_i \leq I_{t-1} + 20\%$
- c) për tabelën nr.3, nën shporta nr.2, thirrje kombëtare midis rajoneve, brenda rrjetit, familjare: $\sum w_i \cdot \Delta p_i \leq I_{t-1} - 15\%$
- d) për tabelën nr.4, nën shporta nr.3, biseda telefonike lokale: $\sum w_i \cdot \Delta p_i \leq I_{t-1} + 10.5\%$
- e) për tabelën nr.5, nën shporta nr.4: biseda telefonike ndërkombëtare: $\sum w_i \cdot \Delta p_i \leq I_{t-1} - 15\%$

12. Kolona nr.12 i referohet detyrimit të ALBTELECOM si në kolonën nr. 5 (shiko shënim 5), por për periudhën nën rregullim në vijim (t). Kjo kolonë të plotësohet me vlerën e detyrimit në periudhën në vijim në rast se njihet në avancë nga ALBTELECOM, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me operatorë të tjerë, ose me vlerat e tarifave të rregulluara nga ERT, sipas metodologjive përkatëse. Në rast të kundërt, lihen bosh ose plotësohen me të njëjtën vlerë si kolona nr. 5 (shih shënim 5).

13. Kolona nr.13 i referohet tarifës së përdoruesit që do aplikohet nga ALBTELECOM në periudhën nën rregullim në vijim (t). Për thirrjet brenda rrjetit kjo tarifë është e njëjtë me tarifën e propozuar nga ALBTELECOM në kolonën nr.9, ndërsa për thirrjet jashtë rrjetit ALBTELECOM, tarifa e përdoruesit që do aplikohet duhet të jetë e barabartë me shumën e pjesës së mbajtur të propozuar nga ALBTELECOM në kolonën nr.9 dhe detyrimit në kolonën nr.12, me kushtin që tarifat dhe pjesët e mbajtura të propozuara nga ALBTELECOM të miratohen nga ERT. Në rast të reduktimit të detyrimit në kolonën nr.12 gjatë periudhës nën rregullim në vijim (t), ALBTELECOM duhet të reduktojë tarifën e përdoruesit në masë absolute të njëjtë me reduktimin e detyrimit.

14. Tabelat e plotësuara duhet të depozitohen nga ALBTELECOM në formë të printuar dhe në formë elektronike në CD në formatin EXCEL.

VENDIM

Nr.855, datë 18.6.2008

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË ORGANIZMIT ME FUQI TË NDJESHME NË TREG, "ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS" (AMC) SH.A.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 58, 59, 60 dhe 62 të ligjit nr. 8618, datë 14.6.2000 "Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave të interkonjeksionit, të organizmit me fuqi të ndjeshme në treg, "Albanian Mobile Communications (AMC) sh.a.", e cila i bashkëlidhet këtij vendimi (Lidhja nr.1).

2. Miratimin e metodologjisë e rregullimit të tarifave të shërbimeve të përdoruesve fundorë të organizmit me fuqi të ndjeshme në treg, "Albanian Mobile Communications" (AMC) sh.a., sipas lidhjes nr.2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ky vendim është i vlefshëm për periudhën e parashikuar në metodologjitë që i bashkëlidhen këtij vendimi (Lidhjet nr.1 e nr.2).
4. Ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1

**METODOLOGJIA E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË INTERKONJEKSIONIT
TË AMC SHA**

1. Objekti i kësaj metodologjie është rregullimi i tarifës për ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular të operatorit AMC.
2. AMC të aplikojë të njëjtën tarifë për terminimin e thirrjeve në rrjetin e tij, pavarësisht origjinës së trafikut, në përmbushje të detyrimit për të ofruar shërbimin e terminimit të thirrjeve të origjinuara nga përdoruesit e rrjeteve publike të telekomunikacioneve dhe të thirrjeve të transituara nga operatorët e licencuar nga ERT për ofrimin e shërbimeve të transitit kombëtar e ndërkombëtar.
3. Rregullimi i tarifës së terminimit bëhet duke përcaktuar nivelin maksimal të tarifave në secilën periudhë rregullimi.
4. Rregullimi i tarifës të shërbimit të interkonjeksionit sipas kësaj metodologjie do të bëhet për një kohëzgjatje dyvjeçare, e cila përfshin dy periudha njëvjeçare.
5. Vlerat maksimale të tarifës të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular të operatorit AMC sh.a. për periudhat nën rregullim paraqiten në tabelën nr.1, në vijim.

Tabela nr.1. Vlerat maksimale të tarifës të terminimit të AMC

	Periudha e I-rë	Periudha e II-të
Tarifa (lek/minutë)	11.95	10.50

6. Tarifa e interkonjeksionit për kohëzgjatjen shoqërohet edhe me tarifën për numrin e thirrjeve të terminuara ose transituara, të cilat përcaktohen në masën jo më shumë se 3% përkundrejt tarifës përkatëse për kohëzgjatjen. Tarifat për numrin e thirrjeve zbatohen vetëm për thirrjet të cilat, sipas rekomandimeve përkatëse të ITU, janë të suksesshme.
7. Nëse gjatë procedurës së rregullimit të tarifave, ERT evidenton që operatori nën rregullim kryen veprime që cenojnë konkurrencën në treg, do t'i trajtojë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Data e fillimit të rregullimit përcaktohet me vendim të ERT, i cili merret jo më vonë se 30 ditë mbas hyrjes në fuqi të metodologjisë.

METODOLOGJIA E RREGULLIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMEVE TË PËRDORUESVE FUNDORË TË AMC SH.A.

1. Objekti i kësaj metodologjie është rregullimi i tarifave për shërbimet publike telefonike të lëvizshme, që u ofrohen përdoruesve nëpërmjet paketës tarifore me parapagim “ALBAKARTA”:

- a) Thirrje telefonike brenda rrjetit AMC;
- b) Thirrje telefonike kombëtare drejt rrjeteve të tjerë celularë;
- c) Thirrje telefonike kombëtare drejt rrjeteve fikse;
- d) Thirrje telefonike ndërkombëtare.

2. Rregullimi i tarifave, që janë objekt i kësaj metodologjie, bëhet sipas metodës “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” (Price cap).

3. Formula e “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave”, ku bazohet rregullimi i tarifave, është:

$$\sum_{i=1}^n w_{i,t} \left[\frac{p_{i,t} - p_{i,t-1}}{p_{i,t-1}} \right] \leq I_t - X_t$$

ku :

- t* : periudha kohore për të cilën vendoset tarifa;
- i* : indeksi i shërbimit në shportën nën rregullim ($i = 1, 2, 3, \dots, n$);
- n* : numri i shërbimeve në shportën nën rregullim;
- $p_{i,t}$: tarifa (çmimi për njësi) i shërbimit *i* në periudhën *t*;
- $p_{i,t-1}$: tarifa (çmimi për njësi) i shërbimit *i* në fund të periudhës paraardhëse të periudhës *t*;
- $w_{i,t}$: pesha e përdorur e shërbimit *i* në periudhën *t*;
- X_t : faktori i produktivitetit i përdorur në periudhën *t*;
- I* : faktori i inflacionit për periudhën *t-1*;

4. Rregullimi i tarifave me metodën “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” do të aplikohet për një kohëzgjatje dyvjeçare. Kohëzgjatja dyvjeçare përfshin 2 (dy) periudha vjetore.

5. Metoda “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave” do të aplikohet për shportën dhe nënshportat e shërbimeve të paraqitura në shtojcën nr.1, pjesë e kësaj metodologjie.

6. Pjesa e mbajtur për thirrjet drejt rrjeteve të tjerë llogaritet si diferencë e tarifës së përdoruesit me detyrimin për terminim dhe/ose transitim ndaj operatorëve të tjerë.

7. Peshat e të ardhurave nga shitja e shërbimit i “wi” llogariten si raport i të ardhurave nga shërbimi ‘i’ me të ardhurat e përgjithshme të shërbimeve në nënshportë/shportë, për vitin kalendarik paraardhës. Peshat e shërbimeve “wi” për periudhën e parë të rregullimit do të jenë peshat e shërbimeve të përlogaritura nga ERT në bazë të dhënave të vitit 2006, të depozituara nga AMC dhe të paraqitura në shtojcën nr.1, bashkëngjitur. Për periudhën e dytë të rregullimit, operatori duhet të depozitojë të dhënat e detajuara të shërbimeve nën rregullim për vitin 2008.

8. Tarifa fillestare ($p_{i,t-1}$) në formulën “Kufiri maksimal i normës së ndryshimit të tarifave”, për secilin shërbim nën rregullim, do të jetë tarifa në fund të periudhës paraardhëse.

9. Vlerat vjetore të faktorit X për shportën dhe nënshportat e shërbimeve nën rregullim (shtojca nr. 1), do të jenë :

a) Shporta e përgjithshme:

$$X_s = +23\%$$

b) Nën shporta nr.1: Pjesa e mbajtur për thirrjet kombëtare drejt rrjeteve celulare të tjerë:

$$X_1 = +28\%;$$

c) Nën shporta nr.2 : Pjesa e mbajtur për thirrjet kombëtare drejt rrjeteve fiks:

$$X_2 = +28\%;$$

Vlerat e faktorit X mbeten të pandryshuara për secilën periudhë vjetore rregullimi.

10. Vlera e faktorit It (faktori i inflacionit i përdorur për periudhën t) do të jetë i barabartë me normën e ndryshimit vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) të vitit kalendarik paraardhës, të publikuar nga Instituti i Statistikës (INSTAT). Vlera e normës së inflacionit për vitin 2007, që do të përdoret për periudhën e parë nën rregullim është 3.1%.

11. AMC duhet të paraqesë propozim për ndryshim të tarifave për secilën periudhë rregullimi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga fillimi i periudhës përkatëse.

12. AMC nuk është i kufizuar në lidhje me numrin e propozimeve për ndryshim të tarifave brenda secilës periudhë rregullimi, me kusht që të përmbushë kërkesat e kësaj metodologjie.

13. AMC ka të drejtë që, brenda secilës periudhë rregullimi, të aplikojë tarifa më të ulëta se ato të konfirmuara nga ERT, duke plotësuar, në çdo rast, detyrimet për njoftim të ERT, si dhe të përdoruesve.

14. Propozimi për ndryshim të tarifave duhet të përmbajë të gjithë informacionin e nevojshëm, të kërkuar sipas kësaj metodologjie. ERT, mund të kërkojë, gjithashtu, informacion shtesë për të verifikuar nëse propozimet e paraqitura, përmbushin kërkesat e metodologjisë. Në mungesë të informacionit të nevojshëm, ERT ka të drejtë të përdorë metoda alternative për përlllogaritjen e treguesve të kërkuar.

15. ERT verifikon përputhshmërinë e tarifave të propozuara me kërkesat e metodologjisë dhe, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e propozimit, njofton AMC për rezultatet e verifikimit.

16. Për çdo ndryshim të tarifave, i licensuari detyrohet t'i njoftojë përdoruesit me anë të mjeteve të informimit publik, të paktën 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave të reja dhe ky njoftim duhet të zgjase jo më pak se 3 ditë rresht.

17. AMC mund të zbatojë kohë minimale të tarifimit për thirrjet telefonike (start up fee), e cila nuk duhet të jetë më shumë se 15 sekonda.

18. AMC gjatë periudhës nën rregullim nuk mund të propozojë apo aplikojë rritje të tarifave të shërbimeve celulare për planin tarifor nën rregullim ALBAKARTA dhe për planet e tjera tarifore, me parapagim apo me kontratë.

19. AMC gjatë periudhës nën rregullim duhet të sigurojë vazhdueshmërinë e ofrimit të shërbimeve celulare nëpërmjet planit tarifor ALBAKARTA, për përdoruesit aktualë dhe përdoruesit e rinj të mundshëm, si edhe të mos përkeqësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara.

20. Në zbatim të kësaj metodologjie, tarifat të shprehura në monedha të huaja do të konvertohen në lek, sipas kursit mesatar vjetor, llogaritur në bazë të të dhënave të publikuara nga Banka e Shqipërisë për vitin kalendarik paraardhës.

21. Nëse ERT konstaton se operatori nën rregullim zbaton tarifa në kundërshtim me metodologjinë, ose që cenonjë konkurrencën në treg, do t'i trajtojë ato në përputhje me legjislacionin në fuqi.

22. Shtojca nr.1 dhe shënimet janë pjesë integrale e kësaj metodologjie.

23. Data e fillimit të rregullimit përcaktohet me vendim të ERT, i cili merret jo më vonë se 30 ditë mbas hyrjes në fuqi të metodologjisë.

SHTOJCA Nr. 1

Tabela Nr. 1 : SHPORTA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE NEN RREGULLIM

AMC
Albakarta

Nr	Shërbimi	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) ëleke/njesi]			Të ardhura (t-1) ëlekë]	Pesha (Wi) ë %]	Tarifa e propozuar (t) ëleke/njesi]	Ndryshimi	KONTROLLI ë %]	Detyrimi për të tjerë (t) ëleke/njesi]	Tarifa e përdoruesit (t) ëleke/njesi]
		Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1	2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Biseda telefonike brenda rrjetit AMC							0.5585					
2	Biseda telefonike kombëtare drejt operatorëve të tjerë celularë							0.2529					
	2.1 minuta e parë							0.2276					
	2.2 mbi një minutë							0.0253					
3	Biseda telefonike kombëtare drejt rrjeteve fiks :							0.0317					
	3.1 Altelecom												
	3.1.1 minuta e parë							0.0285					
	3.1.2 mbi një minutë							0.0032					
	3.2 Operatorëve të tjerë fiks me interkoneksion indirekt												
	3.2.1 minuta e parë												
	3.2.2 mbi një minutë												
	3.3 Operatorëve të tjerë fiks me interkoneksion direkt												
	3.3.1 minuta e parë												
	3.3.2 mbi një minutë												
4	Biseda telefonike ndërkombëtare drejt:							0.1570					
	4.1.1 ITALI Fiks							0.0166					
	4.1.2 ITALI Celular							0.0605					
	4.2.1 GREQI Fiks							0.0168					
	4.2.2 GREQI Celular							0.0252					
	4.3.1 MAQEDONI Fiks							0.0012					

4.3.2		Celular							0.0049						
4.4.1	KOSOVE	Fiks							0.0012						
4.4.2		Celular							0.0057						
4.5.1	MALI I ZI	Fiks							0.0003						
4.5.2		Celular							0.0020						
4.6.1	GJERMANI	Fiks							0.0038						
4.6.2		Celular							0.0030						
4.7.1	FRANCE	Fiks							0.0013						
4.7.2		Celular							0.0017						
4.8.1	ANGLI	Fiks							0.0010						
4.8.2		Celular							0.0026						
4.9.1	SHBA	Fiks							0.0092						
4.9.2		Celular													
4.10.1	KANADA	Fiks							0.0002						
4.10.2		Celular													
TOTALI									1.0000						

SHTOJCA Nr. 1

Tabela Nr. 2: NËNSHPORTA Nr. 1 E SHËRBIMEVE NËN RREGULLIM

AMC
Albakarta

Nr	Shërbimi	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) [ëlekë/njësi]			Të ardhura (t-1) [ëlekë]	Pesha (Wi) [%]	Tarifa e proponuar (t) [ëlekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI [%]	Detyrimi për të tjerë (t) [ëlekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) [ëlekë/njësi]
		Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1	2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Biseda telefonike kombëtare drejt operatorëve të tjerë celulare												
	1.1 minuta e parë							0.9000					
	1.2 mbi një minutë							0.1000					
	TOTALI												

SHTOJCA Nr. 1

Tabela Nr. 3 : NËNSHPORTA nr. 2 E SHËRBIMEVE NËN RREGULLIM

AMC
Albakarta

Nr	Shërbimi	Sasia (t-1)		Tarifa (t-1) [ëlekë/njësi]			Të ardhura (t-1) [ëlekë]	Pesha (Wi) [%]	Tarifa e propozuar (t) [ëlekë/njësi]	Ndryshimi	KONTROLLI [%]	Detyrimi për të tjerë (t) [ëlekë/njësi]	Tarifa e përdoruesit (t) [ëlekë/njësi]
		Minuta	Nr. Thirrje	Tarifa e përdoruesit	Detyrimi për të tjerët	Pjesa e mbajtur							
	1	2	3	4	5	6 = 4-5	7 = 2x6	8	9	10 = 9/6-1	11 = 8x10	12	13 = 12+9
1	Biseda telefonike kombëtare drejt rrjeteve fiks :												
	1.1 Altelecom												
	1.1.1 minuta e parë							0.9000					
	1.1.2 mbi një minutë							0.1000					
	1.2 Operatorëve të tjerë fiks me interkoneksion indirekt												
	1.2.1 minuta e parë												
	1.2.2 mbi një minutë												
	1.3 Operatorëve të tjerë fiks me interkoneksion direkt												
	1.3.1 minuta e parë												
	1.3.2 mbi një minutë												
	TOTALI												

SHËNIME PËR PLOTËSIMIN E TABELAVE TË SHTOJCËN NR.1 AMC

1. Kolona nr.1 i referohet emërimit të shërbimeve aktuale nën rregullim, të ofruara nga AMC nëpërmjet paketës tarifore me parapagim ALBAKARTA. Në rast të ndryshimit të emërimit të shërbimeve apo mënyrës së tarifimit të këtyre shërbimeve, d.m.th. ofrimit të shërbimeve me tarifa të diferencuara sipas kohëzgjatjes apo kohës së kryerjes së thirrjes, AMC duhet t'i specifikojë këto thirrje si shërbime të veçanta dhe t'i përfshijë në kolonën nr.1, duke plotësuar njëkohësisht edhe kolonat e tjera 2-13.

2. Kolonat nr.2 dhe nr.3 duhet të plotësohen përkatësisht me sasinë e shprehur në “minuta” dhe “numër thirrje” për të gjitha shërbimet e kolonës nr.1, për periudhën kohore paraardhëse (t-1).

3. Kolonat nr. 4, 5 dhe 6 i referohen përkatësisht tarifës së përdoruesit, detyrimit të AMC ndaj operatorëve të tjerë për thirrjet jashtë rrjetit dhe pjesës së mbajtur, për periudhën kohore paraardhëse (t-1). Vlerat e këtyre kolonave të shprehen në lek, me dy shifra dhjetore.

4. Kolona nr.4 i referohet tarifës së përdoruesit për minutë, pa TVSH.

a) Në rast se AMC, përveç tarifës për kohëzgjatjen e bisedës, zbaton edhe një tarifë fikse për thirrje, pavarësisht kohëzgjatjes, në tabelat e shtojcës nr. 1, pas kolonës nr. 4 duhet të shtohet edhe një kolonë tjetër me nr.4/a “Tarifë për thirrje”, plotësuar me vlerat përkatëse.

5. Kolona nr.5 i referohet detyrimit të AMC për terminimin (ose dhe transitimin) e thirrjeve drejt rrjeteve të tjerë fiks dhe celulare, kombëtare dhe ndërkombëtare. Për thirrjet brenda rrjetit në këtë kolonë vendoset vlera zero.

a) Në rast se nga operatorët e tjerë, për terminimin (ose dhe transitimin) e thirrjeve në rrjetin e tyre zbatohet edhe një tarifë fikse për thirrje, pavarësisht kohëzgjatjes, në tabelat e shtojcës nr. 1, pas kolonës nr. 5 duhet të shtohet edhe një kolonë tjetër me nr.5/a “Detyrimi për thirrje”, e cila plotësohet me vlerat përkatëse.

6. Kolona nr.6 i referohet pjesës së mbajtur nga AMC për thirrjet jashtë rrjetit dhe llogaritet si diferencë e tarifës së përdoruesit (kolona nr.4) dhe detyrimit për të tjerë (kolona nr.5). Për thirrjet brenda rrjetit kjo vlerë rezulton e njëjtë me tarifën e përdoruesit.

a) Në rast të aplikimit nga AMC dhe/ose nga rrjetet e tjerë edhe të një tarife fikse për thirrje pavarësisht kohëzgjatjes, duhet të shtohet edhe një kolonë tjetër nr.6/a, “Pjesa e mbajtur për thirrje”, dhe të plotësohet me vlerën përkatëse të barabartë me diferencën e vlerave të tarifës për thirrje (shënimi 4/a) dhe detyrimit për thirrje (shënimi 5/a). Në rast të mosaplikimit të tarifës për thirrje dhe aplikimit të detyrimit për thirrje, pjesa e mbajtur për thirrje të plotësohet me vlerën negative të detyrimit për thirrje.

7. Kolona nr.7 i referohet të ardhurave nga shërbimi përkatës në kolonën nr.1, dhe plotësohet me prodhimin e vlerës në kolonën nr.2 (minuta) dhe vlerës në kolonën nr.6 (Tarifë për minutë), d.m.th. $7=2 \times 6$. Rreshti i fundit i kësaj kolone, totali, të plotësohet me shumën e të ardhurave nga shërbimet e listuara në kolonën e parë.

a) Në rast të aplikimit të shënimi 4/a dhe ose 5/a, kolona nr.7 të plotësohet me shumën e prodhimit të vlerës së minutave (kolona nr.2) dhe tarifës për minutë (kolona nr.6) dhe prodhimit të vlerës së numrit të thirrjeve (kolona nr.3) dhe pjesës së mbajtur për thirrje (shënimi 6/a), d.m.th. $7=2 \times 6 + 3 \times 6/a$.

8. Kolona nr.8 i referohet peshës së çdo shërbimi në kolonën nr.1, dhe përlllogaritet për çdo shërbim “i” si raport i të ardhurave nga shërbimi “i” në kolonën nr.7, me të ardhurat totale nga shërbimet, rreshti i fundit, kolona nr.7. Në rreshtin e fundit të kolonës nr.8 duhet të shënohet shuma e peshave të shërbimeve ($\sum w_i$), e cila duhet të dalë e barabartë me 100%. Vlerat e peshave të shprehen në përqindje me 1 shifër dhjetore. Për periudhën e parë të shtohet një kolonë e re 8/a, me vlerat e përlllogaritura nga AMC sipas të dhënave të raportuara në kolonat 1-7.

9. Kolona nr.9 i referohet tarifës së përdoruesit ose pjesës së mbajtur të propozuar nga AMC për periudhën në vijim (t) nën rregullim, pa TVSH. Për thirrjet jashtë rrjetit AMC kjo kolonë duhet të plotësohet me vlerën e pjesës së mbajtur të propozuar, ndërsa për thirrjet brenda rrjetit me vlerën e tarifës së përdoruesit.

10. Kolona nr.10 i referohet normës së ndryshimit ($\Delta\pi$) midis tarifës/pjesës së mbajtur të propozuar në kolonën nr.9 dhe tarifës/pjesës së mbajtur në periudhën paraardhëse ($t-1$) në kolonën nr.6. Kjo kolonë të plotësohet me vlerën e përlogaritur si raport i vlerave në kolonën nr.9 dhe kolonën nr.6 minus 1, d.m.th. $10 = (9/6)-1$. Vlerat të shprehen me tri shifra dhjetore.

11. Kolona nr.11 të plotësohet me vlerën e barabartë me prodhimin e vlerave të peshave të shërbimeve (kolona nr.8) dhe vlerave përkatëse të normës së ndryshimit (kolona nr.10), d.m.th $11=8 \times 10$. Rreshti i fundit i kolonës nr.11 të plotësohet me shumën e vlerave të kësaj kolone $\sum w_i \cdot \Delta\pi_i$. Të bëhet kujdes në mospërfshirjen dy herë të vlerave për një shërbim me tarifa të diferencuara. Në mënyrë që tarifat (pjesa e mbajtur) të propozuara nga AMC në kolonën nr.9, të përmbushin kriteret e rregullimit të metodologjisë dhe të miratohen nga ERT, vlera e kësaj qelize të matricës duhet të jetë më e vogël ose e barabartë me vlerën e shprehjes së përcaktuar në tabelën përkatëse:

a) për tabelën nr.1, shporta e përgjithshme: $\sum w_i \cdot \Delta\pi_i \leq It-1-23\%$

b) për tabelën nr.2, nën shporta nr.1: $\sum w_i \cdot \Delta\pi_i \leq It-1-28\%$

c) për tabelën nr.3, nën shporta nr.2: $\sum w_i \cdot \Delta\pi_i \leq It-1-28\%$

12. Kolona nr.12 i referohet detyrimit të AMC si në kolonën nr. 5 (shih shënim 5), por për periudhën nën rregullim në vijim (t). Kjo kolonë të plotësohet me vlerën e detyrimit në periudhën në vijim, në rast se njihet në avancë nga AMC, sipas marrëveshjeve të nënshkuara me operatorë të tjerë ose me vlerat e tarifave të rregulluara nga ERT, sipas metodologjive përkatëse. Në rast të kundërt, lihen bosh ose plotësohen me të njëjtën vlerë si kolona nr.5 (shih shënim 5).

13. Kolona nr.13 i referohet tarifës së përdoruesit që do aplikohet nga AMC në periudhën nën rregullim në vijim (t). Për thirrjet brenda rrjetit kjo tarifë është e njëjtë me tarifën e propozuar nga AMC në kolonën nr.9, ndërsa për thirrjet jashtë rrjetit AMC, tarifa e përdoruesit që do aplikohet duhet të jetë e barabartë me shumën e pjesës së mbajtur të propozuar nga AMC në kolonën nr.9 dhe detyrimit në kolonën nr.12, me kushtin që tarifat dhe pjesët e mbajtura, të propozuara nga AMC, të miratohen nga ERT. Në rast të reduktimit të detyrimit në kolonën nr.12 gjatë periudhës nën rregullim në vijim (t), AMC duhet të reduktojë tarifën e përdoruesit në masë absolute të njëjtë me reduktimin e detyrimit.

14. Tabelat e plotësuara duhet të depozitohen nga AMC në formë të printuar dhe në formë elektronike në CD në formatin EXCEL.

VENDIM

Nr.856, datë 18.6.2008

PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 10 për qind, të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme, të pleqërisë, të pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar në përputhje me vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”, miratuar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994.

2. Rritjen, në masën 15 për qind, të:

a) pensioneve, të plota dhe të pjeshme, të pleqërisë, të pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) pensioneve, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Rritja e pensioneve, e parashikuar në këtë vendim, të zbatohet edhe për shtesat mbi pension, të dhëna në përputhje me nenet 33, 38 e 39 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”.

4. Rritje, sipas parashikimeve në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, përfitojnë edhe pensionet, të cilat caktohen nga data 1.7.2008 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2008, përfshirë edhe këtë datë.

5. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensionave, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1.7.2008 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 9515 (nëntë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 19 030 (nëntëmbëdhjetë mijë e tridhjetë) lekë në muaj.

6. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2008 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 5200 (pesë mijë e dyqind) lekë në muaj.

7. Pensionistët, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato të caktuara sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit, në masën e caktuar në pikën 1, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave në masën e përfituar sipas vendimeve nr.401, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, dhe nr.763, datë 27.11.2006 të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”.

8. Pensionistët, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, edhe pas rritjes së pensionit, në masën e caktuar në pikën 2 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e të ardhurave, në masën e përfituar nga zbatimi i vendimit nr.17, datë 20.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

9. Kompensohen:

a) sipas kriteve dhe masës së përcaktuar në vendimet nr.401, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, dhe nr.763, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, pensionistët që do të përfitojnë pension të plotë pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato, të caktuara sipas

paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, kur të ardhurat mujore të tyre janë deri në 11 275 lekë, ndërsa të ardhurat për pensionistët, që do të marrin pension të pjesshëm, kompensohen në proporcion ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë minimal, por jo më shumë se 1260 lekë në muaj;

b) sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në vendimin nr.763, datë 27.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, pensionistët, që do të përfitojnë pension të plotë invaliditeti apo familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përjashtuar ato, të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të këtij ligji, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, kur të ardhurat e tyre mujore janë deri në 10 775 lekë, ndërsa të ardhurat për invalidët, që do të marrin pensione të pjesshme, kompensohen në proporcion ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë minimal, por jo më shumë se 760 lekë në muaj;

c) sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në vendimin nr.17, datë 20.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, pensionistët që do të përfitojnë pension të plotë pleqërie, invaliditeti ose familjar, sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, kur të ardhurat mujore të tyre janë deri në 6090 lekë, ndërsa të ardhurat për pensionistët, që marrin pension të pjesshëm, kompensohen në proporcion ndërmjet pensionit individual dhe pensionit të plotë, por jo më shumë se 690 lekë në muaj.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimin i këtij vendimi, përllogariten në shumën 2 668 (dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) milionë lekë dhe përballohen nga fondi i kontingjencës, i caktuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, për rritjen e pensioneve.

11. Shpenzimet për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a. përllogariten në shumën 30 (tridhjetë) milionë lekë dhe do të përballohen nga fondi i kontingjencës, i caktuar në Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008.

12. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.61, datë 4.6.2008

FILLIMI I PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHITJES ME SHUMICË TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19. 3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” pika 4.13, germa “a”, pika 2, dhe neneve 18, pika 1, germa “b”, dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.6.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e KESH sh.a. me nr.DEK /IZ 3061 prot, datë 26.5.2008 për përcaktimin e tarifës së shitjes me shumicë të energjisë elektrike, si dhe propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve mbi këtë kërkesë:

Konstaton se:

- Ligji i sektorit të energjisë elektrike përcakton ERE-n si autoritetin e vetëm për përcaktimin e tarifave të shitjes së energjisë elektrike.

- Modeli i tregut të energjisë elektrike i miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, parashikon përfshirjen në tregun e rregulluar të marrëdhënieve ndërmjet furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë.

- KESH sh.a. ka aplikuar në ERE për përcaktimin e tarifave të shitjes me shumicë të energjisë elektrike për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2008, me cilësinë e shoqërisë, njësi e të cilës, në bazë të modelit të tregut, pika 2, paragrafi 9, është furnizuesi publik me shumicë.

- ERE me vendimet nr.18, 20 dhe 21, datë 14.2.2008 ka përcaktuar tarifat e prodhimit, shërbimit të shpërndarjes dhe çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, në kontekst të të cilëve do të përcaktohet çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi publik me shumicë te furnizuesi publik me pakicë.

Për sa konstatoi më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuesit publik me shumicë te furnizuesi publik me pakicë.

2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për ta njoftuar KESH sh.a.-në, mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.62, datë 4.6.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “UNION EOLICA ALBANIA”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, dhe nenit 18 pika 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.6.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Union Eolica Albania” për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimi i energjisë elektrike, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit të përcaktuar në rregulloren e procedurave të licencimit

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Union Eolica Albania” në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimi i energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.6.2008
Doli nga shtypi më 23.6.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë